



REPUBLIKA E SHQIPERISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 348/12 Prot.

Tiranë, më 22/05 /2023

**VENDIM**

**Nr. 15, datë 22.05.2023**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIME NË STRUKTURËN E**  
**UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS NË FAKULTETIN E INXHINIERISË**  
**MEKANIKE**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, germa ç, Statutin e UPT-së, neni 9, pika 3, germa c, në propozimin e njësisë kryesore, në Vendimin e Dekanatit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike Nr. 05, Nr. 73/2 Prot., datë 01.02.2023, në relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike Nr. 348/1 Prot., datë 03.03.2023 të Universitetit Politeknik të Tiranës, Senati Akademik në mbledhjen e datës 22.05.2023,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë kalimin e 1 (një) vendi nga pozicioni "Personel ndihmës akademik/laborant" në Departamentin e Mekanikës në pozicionin "Sekretare mësimore".
2. Të miratojë kalimin e 1 (një) vendi nga pozicioni "Sekretar Departamenti" në Departamentin e Prodhim Menaxhimit në pozicionin "Personel ndihmës akademik/laborant" pranë këtij Departamenti.
3. Të miratojë kalimin e 2 (dy) vendeve nga pozicioni "Personel akademik efektiv" në Departamentin e Prodhim Menaxhimit në pozicionin "Personel akademik efektiv" në Departamentin e Mekanikës.
4. Të miratojë kalimin e 1 (një) vendi nga pozicioni "Personel akademik efektiv" në Departamentin e Prodhim Menaxhimit në pozicionin "Personel akademik efektiv" në Departamentin e Energjitikës.
5. Të miratojë kalimin e 1 (një) vendi nga pozicioni "Personel akademik efektiv" në Departamentin e Tekstilit dhe Modës në pozicionin "Personel akademik efektiv" në Departamentin e Energjitikës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Prof. Dr. Andrea Maliqari**

Në mungesë dhe me porosi

**ZV. REKTORI**

**Prof. Dr. Akli Fundo**

